



Procesverbal i Dëgjimeve për
Buxhetin
e vitit 2023 dhe Kornizën
Afatmesme Buxhetore (KAB)
2023-2025
në
Salla e Kuvendit

INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2023 dhe KAB-in për vitet 2023-2025, u publikua me datë: 01.08.2022 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/08/KALENDARI-I-DEGJIMEVE-BUXHETORE-2022.pdf> në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon:

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.1 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 dhe nenit 18 paragrafi 1, pika 1.7, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, nenit 6 pika 1.3, i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimet Publike në Komuna, Rregullores Komunale për Transparencë me Nr. Prot. 2697, njoftojmë se nga data: 15.08.2022 deri me datë: 18.08.2022 nën organizimin e Drejtorisë për Financa dhe Buxhet dhe anëtarëve të Grupit punues për hartimin e Projekt-Buxhetit të Komunës së Rahovecit, do të organizohen katër (4) dëgjime publike buxhetor, për planifikimin e buxhetit për vitin 2023 dhe KAB-in për vitet 2023-2025.

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendar i dëgjimeve buxhetore për katër (4) dëgjimet buxhetore në komunën e Rahovecit në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/08/KALENDARI-I-DEGJIMEVE-BUXHETORE-2022.pdf> më datë: 01.08.2022.

Po ashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar OJQ-të, Bizneset dhe Grupet e Interesit, Buxhetimi Xhinor ku janë janë të informuar edhe gjinia femerore si dhe Bashkësitë Lokale dhe lagjet urbane përfaqësuesit të shkollave dhe rininë, rreth mbajtjes së dëgjimeve me anë të publikimit të secilit njoftim veç e veç, për secilin vendbanim, në ueb faqe të komunës, shtatë ditë para mbajtjes së dëgjimit në atë vendbanim.

Njoftimi për mbajtjen e dëgjimit buxhetor me Grupet e grave ‘‘Buxhetim Gjinator’’ që veprojnë në Komunën e Rahovecit u publikua më datë: në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/08/NJOFTIM-DEGJIM-BUXHETIMI-GJINOR.pdf>

Njoftimet përveç që janë publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimet u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale Viber dhe WhatsApp.

DËGJIMI PUBLIK NË RAHOVEC

Dëgjimi buxhetor me përfaqësues të Grupet e grave “Buxhetim Gjinator” që veprojnë në komunën e Rahovecit u mbajtë më: 17.08.2022 në Sallen e Kuvendit Komunal Rahovec, me fillim në ora **11:00**.

Zyrtarët pjesëmarrës në këtë dëgjim nga Grupi punes dhe zyrtar komunal ishin: 10

- Femra ishin: 4
- Meshkuj ishin: 6

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin: 27

- Femra ishin: 20
- Meshkuj ishin: 7

Dëshmi janë listat nënshkruese të pjesëmarrësve në këtë dëgjim.

Dëgjimin e shpalli të hapur Drejtori i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, z. Afrim Limani.

Afrim Limani: Përsëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar të pranishëm. Faleminderit që sot jeni këtu.

Jemi sot këtu në dëgjimet buxhetore, për të marrë kërkesat tuaja Grupet e grave “Buxhetim Gjinator”, prioritetet që ju kenë dhe më pas t’i harmonizojmë në planifikimin që bëhet për vitin 2023.

Buxheti për vitin 2023 do të jetë 17,548,240.00 Euro, Paga dhe medijtë në vlerë prej 8,453,088.00 Euro, Mallra dhe Shërbime në vlerë prej 2,133,829.00 Euro, Shërbime Komunal në vlerë prej 370,000.00 Euro, Subvencione dhe Transfere në vlera prej 820,000.00 Euro si dhe Investimet Kapitale kapin vlerën prej 5,711,323.00 Euro, Mall. Ju lus që kërkesat edhe pasi t’i paraqisni këtu, me shkrim dhe të protokoluara si sjellni dhe në Komunë, që më pas të cëdohen nëpër drejtoritë përkatëse. Nëse ka dikush nga kolegët e KPF-së mund të bashkangjiteni, nëse jo urdhëroni ju të pranishëm të bëni kërkesat e juaja.

Besmire Bytyçi: Të nderuar përsëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat janë:

- Lirimi i trotuarëve nga veturat, Ndriqimi public në qytet,

Habibe Haxhimustafa, zyrtare: Të nderuar të pranishëm, përsëndetje!

Kërkesat janë:

- Kërkesa zyren për barazi gjinore, që në kuadër të kesaj zyre të rritet buxheti për zyren për barazi gjinore.
-

Blerina Hajda, OJQ hareja: Të nderuar të pranishëm, përsëndetje!

Kërkesat nga OJQ hareja janë:

- Rritja e buxhetit shtesë për personat me nevoja të veqanta,

Melinda Oruqi Isma : Të nderuar përsëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat janë:

- Aparatur për kryerjen e analizave të papatestit.

Sahadete Dula : Të nderuar përsëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat janë:

- Hapja e rrugës në mes të dy varrezave në Lagjen e Epërme.

Afrim Limani: Faleminderit juve që jeni prezent dhe keni paraqitur kërkesat tuaja.

Mirë u takofshim!

Dëgjimi publik përfundoi në orën: 11:40

Rahovec, 14.9.2022

Ekrem Bytyqi

Kryesues i Grupit Punues